




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

WWW.UMED.EDU.AL



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. prot. 5047/15, datë 24.10. 2022

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

Nr. prot. 2514/2, datë 24.10. 2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

dhe

Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Për testimin e informatizuar për maturantët
në kuadër të pranimit në programin “Mjekësi e Përgjithshme”
në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

24 . 10 . 2022

Sot më _____.2022 lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (në vijim referuar “**Marrëveshja**”) midis palëve të mëposhtme:

Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me adresë “Rruga e Durrësit”, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Znj. Evis Kushi, në cilësinë e Ministrit të Arsimit dhe Sportit (në vijim referuar “**MAS**”).

dhe

Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar sipas legjislativit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, me NIPT L31512451U dhe seli në adresën “Rruga e Dibrës”, nr. 371, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Arben Gjata (në vijim referuar si “**Universiteti ose UMT**”),

MEQENËSE:

- (A) Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr. 5047 prot., datë 13.09.2022 ka propozuar provimin/testimin e informatizuar të kandidatëve maturantë që aplikojnë në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë (këtu e më poshtë PIND) “Mjekësi e përgjithshme” për vitin akademik 2023-2024.
- (B) UMT-ja me Vendim të Senatit Akademik nr. 80, datë 7.10.2022 “*Për disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin nr.17, datë 22.2.2022*” ka miratuar që pranimet e kandidatëve për studentë në PIND “Mjekësi e përgjithshme”, të bëhen bazuar në rezultatet e arsimit të mesëm dhe maturës shtetërore (70%), si dhe në testimin e informatizuar në lëndët Biologji, Kimi, Fizikë (30%) që do të kryhet nga QSHA-ja.
- (C) QSHA-ja, është institucioni publik në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe përgjegjës për organizimin e testimeve të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe testimin e informatizuar të maturantëve aplikantë në PIND “Mjekësi e përgjithshme”, në lëndët Biologji, Kimi, Fizikë.

Palët e konsiderojnë përfshirjen e testimit të informatizuar/provimi i digitalizuar, si një mjet të vlefshëm për të siguruar cilësinë e pranimit në Universitet bazuar në kriterë aftësie.

PËR SA MË SIPËR, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

1. OBJEKTI I BASHKËPUNIMIT

Objekti i kësaj Marrëveshje është organizimi dhe realizimi i testimit të informatizuar/provimit të digitalizuar nga QSHA-ja, si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në zbatim të kësaj marrëveshje, për të gjithë aplikantët maturantë që kanë përzgjedhur në preferencat e tyre sipas formularit të aplikimit, për të studiuar në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, në Fakultetin e Mjekësisë të UMT-së; përgatitja e fondit të pyetjeve dhe

informimi i maturantëve që synojnë të aplikojnë në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, për vitin akademik 2023-2024.

2. PËRSHKRIM I SHKURTËR

- 2.1 Në kuadër të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, palët do të bashkëpunojnë dhe angazhohen që sipas detyrimeve të tyre, përcaktuar në këtë marrëveshje të informojnë, organizojnë, zhvillojnë, realizojnë testimin e informatizuar për kandidatët maturantë të cilët aplikojnë në programin të studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Fakultetin e Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në përputhje me kriteret e miratuara.
- 2.2 Qëllimet e kësaj Marrëveshje janë:
 - 2.2.1 Përcaktimi i procedurës së testimit për pranimin e studentëve në PIND “Mjekësi e Përgjithshme” nga QSHA-ja;
 - 2.2.2 Rritja e integritetit dhe realizimi i një procesi transparent, nëpërmjet të cilit do të sigurohet pranimi i studentëve në bazë të rezultateve të arsimit të mesëm dhe maturës shtetërore, si dhe testimit të informatizuar.
 - 2.2.3 Implementimi i korrigjimit të testimit në mënyrë të automatizuar, nëpërmjet sistemit të licencuar për sigurinë, të ofruar dhe në përdorim nga QSHA-ja;
 - 2.2.4 Ndërtimi i testimit të informatizuar, bazuar në praktikat, standartet dhe ekspertizat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e testimeve, për të siguruar cilësinë e tij.

3. PËRGJEGJËSITË E UNIVERSITETIT:

Universiteti i Mjekësisë Tiranë ka këto përgjegjësi:

- 3.1 Zbatimin e kritereve të pranimit sipas VSA nr. 80, datë 7.10.2022, duke konsideruar në masën 30% të pikëve totale, rezultatet nga testimi i informatizuar që do të kryhet nga QSHA, në lëndët Kimi, Fizikë, Biologji;
- 3.2 Bashkëpunimin me QSHA-në, në përcaktimin dhe propozimin për miratim të tarifës së testimit të informatizuar, sipas legiislacionit në fuqi, duke marrë në konsideratë mundësinë e vendosjes së tarifave për shërbimin e kryer;
- 3.3 Vënien në dispozicion të QSHA-së, të listës së aplikantëve maturantë që kanë përzgjedhur PIND “Mjekësi e Përgjithshme” sipas formularit të aplikimit.
- 3.4 Publikimin në faqen zyrtare të UMT-së dhe FM-së, të njoftimit për detyrimin e kryerjes së testimit të informatizuar në QSHA, sipas kalendarit dhe përcaktimeve të rregullores specifike të nxjerrë dhe miratuar nga QSHA- ja.
- 3.5 Publikimin e fondit të pyetjeve në faqen zyrtare të UMT-së dhe FM-së, sipas kalendarit.

4. PËRGJEGJËSITË E MAS:

Qendra e Shërbimeve Arsimore si institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka këto përgjegjësi:

- 4.1 Organizon testimin e informatizuar/provimin e digjitalizuar nëpërmjet krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin e testimit të aplikantëve, duke siguruar përgatitjen e pyetjeve sipas standardeve, administrimit transparent dhe korrekt të procesit të testimit, si dhe korrigjin e automatizuar nëpërmjet sistemit të ofruar nga QSHA-ja, në zbatim të standardeve të sigurisë dhe cilësisë dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshje.
- 4.2 Publikon në faqet zyrtare të MAS dhe QSHA njoftimin për detyrimin e kryerjes së testimit të informatizuar në QSHA, sipas kalendarit dhe përcaktive të rregullores specifike të nxjerrë dhe miratuar nga QSHA- ja.
- 4.3 Angazhon ekspertë për koordinimin e punës dhe hartimin e skemës së testimit të informatizuar (*Blueprint*).
- 4.4 Kryen procesin e përzgjedhjes së hartuesve dhe redaktuesve të pyetjeve të testimit të informatizuar, sipas legjisacionit në fuqi, në formatin e pyetjeve me alternativa, si dhe të trajnimit të tyre.
- 4.5 Kryen procesin e hartimit dhe redaktimit të fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar.
- 4.6 Harton fondin e pyetjeve të testimit të informatizuar për vitin akademik 2023-2024, brenda datës 31.12.2022. QSHA-ja ka detyrimin e shpalljes së fondit të pyetjeve në faqen zyrtare dhe përcjelljen e tyre në UMT, brenda datës 31 Dhjetor 2022.
- 4.7 Siguron dhe garanton, në bashkëpunim me MAS, ambientet e kompjuterizuara/informatizuara dhe sistemet e saj, sipas nevojave për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
- 4.8 Bashkëpunon me UMT-në për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përgatitjen dhe kryerjen e testimit të informatizuar, si dhe miratimin e saj sipas legjisacionit në fuqi.
- 4.9 Përgatit kalendarin e hyrjes në testimin e informatizuar të maturantëve aplikantë sipas orareve dhe ditëve përkatëse, duke i shpallur në faqen zyrtare të internetit ato me qëllim informimin e aplikantëve.
- 4.10 Realizon testimin, korrigjin e tyre, si dhe realizimin e shqyrimit të ankimeve të aplikantëve.
- 4.11 Përcjellë në mënyrë zyrtare në Universitet, rezultatet e testimit për të gjithë aplikantët, shprehur në pikë, në formë shkresore dhe elektronike, sipas datës të përcaktuar në kalendarin përkatës.

5. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Palët deklarojnë dhe garantojnë sa më poshtë:

- 5.1 Ata kanë kompetencat dhe autoritetin e plotë për të lidhur këtë Marrëveshje;
- 5.2 Ata kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e lidhjes së kësaj Marrëveshje dhe për përbushjen e detyrimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshje.

6. KOHËZGJATJA DHE ZGJIDHJA

- 6.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga Palët, për një afat kohor të pa caktuar.
- 6.2 Kjo Marrëveshje zgjidhet nga secila Palë në rast se njëra nga palët nuk realizon përgjegjësitë e përcaktuara në marrëveshje.

7. PRONËSIA INTELEKTUALE

- 7.1 Universiteti dhe MAS bien dakord se, çdo produkt apo krijimtari që rezulton nga objekti i kësaj marrëveshjeje, përfshirë të drejtat e pronësisë intelektuale të lidhura me të, janë pronë e vetme e MAS dhe QSHA dhe në kuadër të kësaj marrëveshjeje MAS i jep Universitetit të drejtën ekskluzive për t'i përdorur ato.
- 7.2 Palët bien dakord dhe pranojnë se Universiteti nuk mban përgjegjësi për origjinalitetin dhe/ose cilësinë dhe/ose saktësinë e pyetjeve që do të hartohen dhe redaktohen nga hartuesit dhe redaktuesit e përzgjedhur nga QSHA, por kjo e fundit angazhohet të sigurojë nga hartuesit dhe redaktuesit deklaratë mbi originalitetin dhe/ose cilësinë dhe/ose saktësinë e pyetjeve, sipas rastit.
- 7.3 Palët bien dakord dhe pranojnë se Universiteti, nuk mban përgjegjësi për asnjë fazë të vlerësimit të përfthuar nga testimi i informatizuar i aplikantëve që do të realizohet nga QSHA-ja.
- 7.4 Pa paragjykuar sa më sipër, sistemi i cili është parashikuar të përdoret për zhvillimin e provimit të pranimit është dhe do të mbetet pronë e vetme dhe ekskluzive e QSHA-së.

8. KONFIDENCIALITETI

Secila prej Palëve do të trajtojë si informacion konfidencial çdo informacion që lidhet me çështjet operative dhe teknike, si dhe çdo material ose informacion konfidencial të Palës tjetër, për të cilin ajo vihet në dijeni ose merr si rezultat i nënshkrimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshje. Asnjëra prej palëve nuk do të pérhapë informacion konfidencial që i përket Palës tjetër, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, informacion lidhur me këtë Marrëveshje, apo me veprimtarinë e Palës tjetër, përvçese me pëlqimin paraprak me shkrim të kësaj të fundit.

9. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

- 9.1 Kjo Marrëveshje është hartuar dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 9.2 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim në përbushjen e kushteve dhe angazhimeve të tyre sipas kësaj Marrëveshje. Çdo pretendim ose mosmarrëveshje mes palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet në mirëbesim dhe me mirëkuptim midis palëve.

10. TË NDRYSHME

- 10.1 Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe ka epërsi mbi çdo marrëveshje apo angazhim të mëparshëm, verbal apo me shkrim, të secilës prej Palëve lidhur me objektin në fjalë.
- 10.2 Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje të përbashkët me shkrim të dakordësuar më parë nga palët.
- 10.3 Mosushtimi nga njëra Palë i ndonjë të drejtë apo angazhimi të parashikuar në këtë Marrëveshje, nuk do të konsiderohet në asnjë rast si heqje dorë nga kjo e drejtë apo angazhimi. Asnjë heqje dorë nga të drejtat apo angazhimet e parashikuara në këtë Marrëveshje nuk hyn në fuqi nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Pala përkatëse.
- 10.4 Çdo dispozitë ose term i kësaj Marrëveshjeje përbën një dispozitë të ndarë dhe të pavarur. Nëse ndonjë nga dispozitat e Marrëveshjes është apo shpallet e pavlefshme apo e pazbatushme, kjo pavlefshmëri apo pazbatushmëri nuk do të cenojë vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një dispozitë të vlefshme dhe të zbatueshme me dakordësimin me shkrim të palëve, qëllimi i së cilës i përafrohet sa më shumë të jetë e mundur synimeve të Palëve.
- 10.5 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet që realizohen në kuadër të Marrëveshjes, bëhen me shkrim dhe dërgohen në adresën e titullarëve të institacioneve përkatëse.
- 10.6 Kjo Marrëveshje është nënshkruar në 4 (katër) kopje originale, nga dy për secilën palë.

Palët e mëposhtme e kanë lexuar dhe bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje, e cila hyn në fuqi në datën e përmendur më lart.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT



Evis Kushi
Ministër

Datë: 24.10.2022

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË



Prof. Dr. Arben Gjata
Rektor

Datë: 24.10.2022